

RREGULLA TEKNIKE PER PRODHIMIN E MATERIALIT SHUMEZUES TE ÇERTIFIKUAR PER *VRESHTIN*. *Vitis*

vinifera

1. Repositori duhet të vendoset pranë Institucioneve shkencore.
3. Speciet e përmendura në këtë Aneks mund të shumëzohen me copa ose nëpërmjet shartimit në bimë të së njejtës kategori shëndetësore.
4. Materiali që nuk është konform kushteve të kërkuara do të nxirret jashtë procesit të çertifikimit nga Institucionet e percaktuara.

Kontrollet shendetesore dhe gjenetike kryhen si me poshte:

a) Ne materialin parabaze dhe baze:

- Kontrollet shendetsore duhet të kryhen konform protokollit për specien

Parashikohen dy tipe kontrollesh:

- - *vizual*: gjatë periudhës së evidentimit më të mirë simptomatologjik për sëmundjet e veçanta
- - *analiza*: duke ndjekur protokollin për specien siç parashikohet në Tabelën 1.
- 10% e bimëve do të analizohen çdo vit në mënyrë që çdo bimë të analizohet së paku një herë në 10 vjet.

b) Ne bimet meme te çertifikuara:

- Parashikohet vetem *inspektim vizual* që kryhet gjatë periudhës kur sëmundjet gjejnë shprehjen më të qartë simptomatologjike.

Karakteristikat teknike qe duhet te permbushin ;

Blloku themelor, Vreshti meme dhe Fidanishtja

a) Blloku themelor për kultivarët dhe për nënshartesat duhet të përmbushë keto kushte:

- - Vreshti duhet të vendoset në kushte tokësore të mira dhe që përmbushin kërkesat shëndetsore, ku nuk janë kultivuar drufrutorë së paku për pesë vjet;
- - Toka duhet të jetë e pastër nga nematoda vektore të viruseve të vreshtit të njohura për zonën (*);

- - Parcelat duhen të jenë homogjene, të indentifikohen me lehtësi dhe të kultivojnë vetëm material bazë;
- - Parcelat duhen të kenë një zonë mbrojtëse të paktën 20 metra nga specie që strehojnë të njejtat viruse me vreshtin;

- - Në parcelë rreshtat duhet të dallohen sipas kultivarit dhe klonit. Kur kultivarë ose klone të ndryshëm vendosen në të njëjtin rresht ato duhen të jenë jo më pak se katër metër larg;
- - Bimët duhen të mbrohen mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet e ndryshme;
- - Blloqet duhen të izolojnë nga rrjedhja e ujrave sipërfaqësore, uji vaditës duhet të jetë i pastër nga patogjenët dhe vektorët e tyre;
- - Blloku themelor nuk mund të mbahet më shumë se 12 vjet;

- c) Fidanishtet me bimë të çertifikueshme duhet të përmbushin keto kushte:
- - Fidanishtet duhen të vendosen në toka që plotësojnë kërkesat bujqësore dhe shëndetësore si në rastin e vreshtit mëmë dhe që nuk kanë kultivuar pemë frutore së paku tre vjet.
- - Fidanishtja duhet të ndahet në parcela homogjene të indentifikueshme duke rritur vetëm bimë hardhie.
- - Parcela duhet të rrethohet nga një bord së paku 2 metra, i cili duhet të punohet dhe të pastrohet nga çdo lloj vegjetacioni.

- - Në rreshta, çdo kultivar ose klon si dhe çdo kombinim shartimi duhet të jetë 1m larg.
- - Fidanishtja duhet të mbrohet mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet.
- - Çdo parcelë duhet të jetë 4 metra larg nga fidanishte të tjera hardhie me material të paçertifikuar.

- (*) Analizë nematologjike e tokës për të vlerësuar praninë e nematodave vektore të viruseve. Mostrat duhet të merren në periudhën e duhur(pranverën e vonë) para punimit. Për çdo hektar dohet të merren 10 mostra të përbëra secila nga 5 kampione të ndryshme.

PROTOKOLL PER VLERESIMIN E GJENDJES SHENDETSORE TE HARDHISE DHE NENSHARTESAVE TE SAJ PER ÇERTIFIKIMIN “PA VIRUSE”

<i>SHKAKTARI</i> (teknika)	<i>PROVAT BIOLOGJIKE</i> <i>Indikatorët drunorë</i>	<i>Indikatorët barishtorë</i>	<i>PROVAT SEROLOGJIKE</i>
(GVA, GVB)	(*)		ELISA
GFLV ELISA	<i>Vitis rupestris</i> St. George	(*)	
GFKV	110 R (<i>V. rupestris</i> x <i>V. berlandieri</i>) <i>Vitis rupestris</i> St. George		ELISA
	<i>Vitis riparia</i> Gloire de Montpellier		
	<i>Vitis rupestris</i> St. George		
	LN 33		
	Kober 5BB		
	LN 33		
(GLRaV I, II and III)	<i>V. vinifera</i> cv. Mission, , Cabernet franc.		ELISA